6. ZHVILLIMET NË SISTEMET E PAGESAVE

(39) Gjatë periudhës, infrastruktura bazë për klerimin dhe shlyerjen e pagesave në monedhë vendase ka vijuar të funksionojë me siguri dhe efikasitet, duke mbështetur qëndrueshmërinë e sistemit financiar dhe zbatimin e politikës monetare. Në terma të aktivitetit të procesimit, në sistemin AIPS u kleruan 63,885 pagesa me një vlerë prej 4,097 miliardë lekësh, gjatë

Grafik 6.1 Ecuria e aktivitetit në AIPS dhe AECH për gjashtëmujorin e dytë 2017



Burimi: Banka e Shqipërisë.

periudhës. Numri i transaksioneve është rritur me 3.45%, ndërsa vlera e transaksioneve ka pësuar një rënie prej 6.36%, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit. Paralelisht, në sistemin e pagesave me vlerë të vogël AECH, gjatë periudhës, janë kleruar 294,068 pagesa, me një vlerë mesatare për transaksion prej rreth 177,000 lekësh. Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit, aktiviteti i sistemit AECH ka regjistruar rritje si në numër ashtu edhe në vlerë transaksionesh, me përkatësisht 13.4% dhe 13.7%.

Grafik 6.2 Ecuria e instrumenteve të pagesave në sasi dhe në vlerë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(40) Në lidhje me instrumentet e pagesave, janë kryer rreth 7 milionë pagesa me një vlerë totale prej 2,350 miliardë lekësh, duke reflektuar një rritje të numrit të transaksioneve me 10% krahasuar me

gjashtëmujorin e parë të vitit. Transfertat e kreditit vijojnë të mbizotërojnë në instrumentet e pagesave, por pesha e këtij instrumenti ka rënë, për shkak të rënies në numër dhe në vlerë të këtyre instrumenteve në formën "letër". Nga ana tjetër, është vënë re një rritje e numrit dhe vlerës së transfertave të kreditit në formën "joletër"[33], si dhe një rritje e numrit dhe vlerës së transaksioneve të kryera me karta.

[33] *Internet banking dhe mobile banking.*